



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

PPP.nr.1477/2020

Numri i lëndës: 2020:132694

Datë: 05.07.2021

Numri i dokumentit: 01957970

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike përmbaremore të kreditorit Sh. M., përfaqësuar nga S. K., avokat në P., kundër debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, me seli në Prishtinë, për përmbaremin e vendimit të dhënë në procedurën administrative, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit parashtuar kundër urdhrin për lejimin e përmbaremit P.nr.1011/20, të datës 28.05.2020, lëshuar nga përmbareuesi privat A. M., me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 05.07.2021, dha këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, me seli në Prishtinë, ashtu që SHFUQIZOHET urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.1011/20, i datës 28.05.2020, lëshuar nga përmbareuesi privat A. M., me seli në Prishtinë.

II. ANULOHEN të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në këtë çështje përmbaremore.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Kreditori, pranë përmbauesit privat A. M., i caktuar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka parashtruar propozim për përmbaerim në bazë të dokumentit përmbaerimit – Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020.

Përmbauesi privat A. M., i caktuar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin P.nr.1011/20 të datës 28.05.2020, ka lejuar përmbaerimin e propozuar.

Kundër urdhrin të cekur në paragrafin e mësipërm, debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim. Në prapësim, debitori pretendon se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar përmbaerimi nuk mund të paraqitet si dokument ekzekutiv dhe se i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbaerim ashtu siç kërkohet me nenin 27 të Ligji për Procedurën Përmbaerimore. Ka shtuar se urdhri përmbaerimor është lëshuar në kundërshtim me nenin 71 dhe 73 par. 3 të LPP. Nga këto të cekura ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbaerimor i goditur me prapësim.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit tërësisht dhe të lihet në fuqi urdhri përmbaerimor.

Gjykata, pasi që ka bërë shqyrtimin e pretendimeve në prapësim dhe shkresat tjera të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit duhet të aprovohet si i bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dokumenti përmbaerimor me të cilin është iniciuar procedura përmbaerimore në këtë çështje juridike, përkatësisht Vendimi i Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, me të cilin është obliguar debitori që në afat prej 8 ditëve të bëjë kompensimin në vlerë të një page, në emër të shpërblimit jubilarë për kreditorin, nuk është i përshtatshëm për përmbaerim për faktin se në të nuk është përcaktuar shuma e përmbushjes së detyrimit.

Me nenin 22 par. 1 nën paragraf 1.2 të LPP është përcaktuar se dokument përmbaerues është edhe vendimi përmbaerues i dhënë në procedurë administrative, mirëpo me këtë dispozitë është përcaktuar se çka konsiderohet dokument përmbaerimor, ndërsa

një dokument përbarimor për të shërbyer si titull përbarues patjetër duhet të përmbaj element e përcaktuara me nenin 27 par. 1, të LPP të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përbarimor. Me dispozitën ligjore të nenit 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë komulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se në këtë rast përbaruesi privat e ka lejuar përbarimin dhe e ka cilësuar si titull përbarues Vendimin e Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, vendimi i lëshuar në procedurë administrative, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se vendimi i tillë nuk mund të konsiderohet titull përbarues ngase në dispozitiv nuk e përmban shumën e detyrimit, ashtu siç është përcaktuar me dispozitën ligjore të sipërcituar.

Si rrjedhojë e kësaj, kjo gjykatë vlerëson se prapësimi i debitorit është i bazuar në nenin 71, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar prapësimi mund të bazohet vetëm nëse dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë.

Përfundimisht, kjo gjykatë vlerëson se përbarimi në këtë çështje përbarimore është caktuar pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin përbarimor të paraparë me dispozitat e lartcekura të Ligjit për Procedurën Përbarimore, për faktin se titulli ekzekutiv mbi bazën e të cilit është parashtruar propozimi për përbarim, është i papërshtatshëm sepse nuk përmban shumën e përmbushjes së detyrimi.

Kjo gjykatë shqyrtoi edhe parashtresën e dorëzuar nga përbaruesi privat me datë 18.02.2021, me të cilën është bashkëngjitur vendimi i Inspektoratit të Punës nr. 01/21-1178, i datës 18.11.2020, për korrigjimin e gabimeve në vendimin 01 Nr. 21-1715/94 të datës 10.02.2020, dhe vlerëson se titulli përbarues është ai dokument mbi bazën e të cilit inicohet procedura e përbarimit dhe realizohet kërkesa e përmbajtur në të. Me asnjë veprim të mëvonshëm, duke përfshirë vendimin për korrigjimin e gabimeve dhe ekspertizën financiare të datës 28.10.2020, nuk mundet të zëvendësohet titulli përbarues

mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbarimit, siç është bërë përpjekje në këtë rast, andaj kjo gjykatë nuk i mori për bazë këto ndryshime.

Nga të cekurat si më lartë e në bazë të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.1477/2020, më 05.07.2021

Përparim Zeka

---

Gjyqtar

### UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit/marrjes së të njëjtit, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.